



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

## **Study program Punë dhe Politikë Sociale (2021/2022)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Kodi	SWSP60
Titulli	Magjistër për punë dhe politikë sociale
Numri në arkiv i akreditimit [60]	03-2037/1
Numri në arkiv i akreditimit []	03-2037/3
Vendimi për fillim me punë	03-2037/3
Data akreditimit	01.07.2021

## **Përshkrimi i programit**

Qëllimet e programit studimor janë:

- Përvetësimi i njohurive për punën sociale me individë, familje, grupe dhe komunitete lokale që janë në rrezik shoqëror ose përballen me probleme sociale.
- Përvetësimi i njohurive për tejkalimin e pabarazive shoqërore dhe kontributin ndaj grupeve sociale të ndjeshme.
- Përvetësimi i njohurive për dhënie të shërbimeve pa diskriminim në bazë të racës, gjinisë, etnisë, përkatësisë religjioze, statusit ekonomik, moshës, etj.
- Përvetësimi i njohurive për krijimin e politikave sociale në fushat e mbrojtjes sociale, sigurimit social, punësimit, arsimimit, strehimit, etj.

## **Karriera**

Programi studimor do të ketë kontribut të rëndësishëm në aftësimin e studentëve për të zhvilluar njohuri inovative, aftësi, shkathtësi dhe kompetenca nga fusha e punës sociale dhe politikës sociale. Si e tillë do të ketë kontribut të rëndësishëm në aftësimin e studentëve të ndërtojnë karrierë profesionale duke fituar kualifikime të arsimit të lartë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Për këtë qëllim, ky program krijon kuadro të cilat do të menaxhojnë me shërbimet sociale, me shkathtësitë e duhura për dhënie të shërbimeve të përshtatura për ti përmbushur problemet bashkëkohore shoqërore të individëve dhe shoqërisë. Në përputhje me strategjitë dhe programet në nivel qendror dhe lokal, në drejtim të përforcimit të rolit të qendrave sociale dhe de- institucionalizimit, të diplomuarit nga ky program do tu përgjigjen nevojave për kapacitete njerëzore në këto struktura dhe sisteme.

## **Rezultatet e të mësuarit**

### **Njohuritë dhe të kuptuarit**

Tregon aftësi dhe kupton fushën shkencore të studimit e cila rritet mbi arsimin e mëparshëm duke përfshirë edhe njohuritë nga fusha teorike, praktike, perspektivat konceptuale krahasuese dhe kritike në fushën e studimit të punës sociale dhe

politikës sociale dhe sipas metodologjisë së duhur. Kuptimi i një fushe specifike dhe njohja e çështjeve aktuale në lidhje me hulumtimet shkencore dhe burimet e reja të njohurive në sferën sociale. Demonstron njohuri dhe kupton teori të ndryshme, metodologji në punën sociale dhe politikën sociale.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

Mund të zbatojë njohurinë dhe kuptimin në mënyrë që tregojnë qasje profesionale në punën apo profesionin. Tregojnë kompetenca për identifikim, analizë dhe zgjidhje të problemeve me të cilat përballen individët, familjet, grupet, bashkësitë lokale dhe fenomenet e tjera në fushën sociale. Ka aftësi për të gjetur dhe vërtetuar argumentet në korniza të fushës së studimit.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

Aftësi të mbledhë, analizojë, vlerësojë dhe prezantojë informacionet, idetë, konceptet nga të dhënat relevante brenda kompetencave të sistemit për mbrotje sociale. Sjell vlerësim të duhur duke marrë parasysh aspektet personale, shoqërore, shkencore dhe praktike që duhet të ketë punonjësi social. Aftësi për të vlerësuar çështje teorike dhe praktike, të jep sqarime për shkaqet dhe të zgjedhë zgjidhjen e duhur.

### **Aftësitë e komunikimit**

Aftësi të komunikojë dhe diskutojë me publikun profesional dhe jo profesional për informata, ide, probleme dhe zgjidhje. Aftësi për pjesëmarrje të pavarur, me qasje profesionale në diskutime specifike shkencore dhe ndërdisiplinore.

### **Aftësitë e të mësuarit**

Merr iniciativën për të identifikuar nevojat për njohuri dhe mësim të mëtutjeshëm me një nivel të lartë të pavarësisë.

## **Lista e lëndëve**

### **Semestri 1**

- [MCDP1010] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [CM153] [6.0 SETK] **Metodika e punës sociale**
- [CM152] [6.0 SETK] **Teoria e punës sociale**
- [CM147] [6.0 SETK] **Politika sociale e Bashkimit evropian**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

### **Semestri 2**

- [MCPA4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## **Description of courses**

### **Lëndë obligative**

- **Metodologjia e hulumtimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe të kuptuarit e teorive të ndryshme shkencore dhe metodologjive. Fillimisht studentëve do t'u shpjegohen konceptet themelore dhe përkufizimet teorike dhe mostrat e të gjitha metodave ekzistuese të hulumtimit, hipoteza të drejtpërdrejta dhe indirekte, variablat, vlefshmëria e rezultateve, BIAS-i dhe paragjykimet dhe cilësitë shkencore dhe metodologjive sasiore të kërkimit dhe qasjet e tjera metodologjike. Për çdo kapitull studentët do të kryejnë edhe detyra praktike. Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: ta dinë dhe ta kuptojnë rëndësinë e koncepteve themelore shkencore; t'i mësojnë teknikat për hulumtim dhe kërkim efikas të informacionit dhe qasje efikase në informacione dhe literaturë relevante; t'i identifikojnë, t'i përshkruajnë dhe t'i formulojnë problemet shkencore; të bëjnë një zgjedhje të kujdesshme të qasjeve alternative kërkimore, të përshkruajnë me kujdes; të krahasojnë dhe të shpjegojnë avantazhet dhe disavantazhet e metodave të ndryshme shkencore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në kërkime sasiore dhe cilësore; t'i aplikojnë metodat themelore shkencore për të analizuar të dhënat sasiore dhe cilësore; të sigurojnë korniza teorike themelore mbi të cilat do të ndërtohen kërkimet; t'i shqyrtojnë ato dhe të bëjnë një vlerësim të publikimeve teknike dhe atyre shkencore.

- **Metodika e punës sociale**

Të fitohen njohuri të thelluara shkencore që paraqesin hyrje në të gjitha sferat që lidhen me punën sociale dhe metodikën e punës me grupet e rrezikuara.

- **Teoria e punës sociale**

Të fitohen njohuri të thelluara shkencore të cilat paraqesin hyrje në të gjitha fushat shkencore që kanë lidhje me punën sociale.

- **Politika sociale e Bashkimit evropian**

Të fitojë njohuri të thella të politikës së sovranitetit social të praktikuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe të fitojë aftësi për të aplikuar programet specifike sociale të BE-së në një kontekst kombëtar.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyrën më të ndërlikuar - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët t'i fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **Puna sociale dhe mbrojtja shëndetësore**

Të fitojnë njohuri për përvojën teorike dhe praktike të zbatimit të mbrojtjes sociale. Studentët, duhet të jenë në gjendje të analizojnë dhe diskutojnë qasjet moderne për mbrojtjen e klientëve dhe për t'u mundësuar atyre që ta zbatojnë atë.

- **E drejta e punës dhe marrëdhëniet e punës**

E drejta e punës është një disiplinë e veçantë dhe e pavarur e së drejtës në sistemin ligjor. Subjekti themelor i studimit dhe rregullimit janë marrëdhëniet e punës në vetvete. Programi i lëndës E drejta e punës përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë - Çështjet e përgjithshme dhe themelore të Ligjit të punës dhe Pjesa e dytë - Marrëdhëniet e punës. Pjesa e parë mbulon çështje të përgjithshme-teorike si: lënda, përkufizimi, kuptimi, vendi në sistemin ligjor, karakteristikat, lidhja me ligjin e punës me disiplina të tjera ligjore, zhvillimi, burimet vendore dhe ndërkombëtare. Përveç vërejtjeve hyrëse, në këtë seksion, vëmendje e konsiderueshme u është kushtuar marrëveshjeve kolektive dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

- **Puna sociale në arsim**

Të fitojnë njohuri të avancuara dhe specifike për kushtet sociale në të cilat zhvillohen institucionet arsimore. Të komunikojë kuptimin e tyre për këto kushte dhe ndryshimet shoqërore nga hulumtimi arsimor, qoftë me gojë ashtu edhe me shkrim; Bërjen e studimeve të vogla përmes: 1. Përgatitjes së pyetjeve përkatëse kërkimore; 2. Bërjes së studimeve; 3. Mbledhjes dhe analizimit të të dhënave në mjediset arsimore dhe sociale; 4. Prezantimit të rezultateve në raporte të shkurtra kërkimore

- **Puna preventive dhe sociale**

Të fitohen njohuri të thella të parandalimit si mënyra themelore dhe më e mirë e mbrojtjes kundër çrregullimeve mendore, çrregullimeve të sjelljes dhe lloje të tjera të problemeve psiko-sociale, metodat dhe parimet e parandalimit primar, sekondar dhe terciar. Të fitojë njohuri për rolin e shërbimeve sociale në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të parandalimit, krijimin e programeve parandaluese, përfshirjen e jo-profesionistëve në aktivitetet parandaluese.

- **Mbrojtja e fëmijëve**

Të fitojë njohuri të thella për aspektet ligjore të mbrojtjes së fëmijëve (aspektin socio-politik dhe normativ-institucional), duke u fokusuar në të drejtat themelore të fëmijëve të përcaktuara në legjisllacionin ndërkombëtar dhe vendor, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre.

- **Zgjidhja e konflikteve**

Njohuri të avancuara për një qasje shkencore për zgjidhjen paqësore të konflikteve nëpërmjet metodave moderne.

Për t'u njohur me mjetet dhe aktivitetet që lidhen me parandalimin e konflikteve, ku ai do të jetë në gjendje të zbulojë me kohë burimet e mundshme. Fitimi i njohurive adekuate për pjesëmarrje aktive në proceset paqeruajtëse, si dhe përgatitja e strategjisë dhe taktikave për aftësi të suksesshme negociuese në procesin e negociimit. Zbatimi i një metodologjie të veçantë të strategjisë dhe taktikave në procesin e negociatave.

- **Ekonomia e politikës sociale**

Prezantimi i kategorive bazë ekonomike që janë të rëndësishme për të kuptuar proceset ekonomike dhe sociale. Të fitojë njohuri dhe përvojë në lidhjen e ekonomisë dhe sistemit social dhe ndikimin në marrëdhëniet dhe politikat shoqërore.

- **Intervenimet emergjente në punën sociale**

Të fitojë njohuri të thella të parimeve themelore të metodave të punës sociale klinike, si dhe problemet themelore psiko-sociale me të cilat ballafaqohen pacientët që kanë nevojë për hospitalizim dhe nevojat e familjeve të tyre. Të fitojë njohuri për faktorët socialë që ndikojnë në shëndetin, qasjet dhe metodat e punës sociale me njerëz me probleme të ndryshme shëndetësore në kujdesin shëndetësor, institucional dhe joinstitucional, si dhe fitimin e njohurive për problemet shëndetësore si pasojë e stresit.

- **Puna sociale në organizimin e komunitetit**

Studentët marrin njohuri shkencore dhe të thella për kontributin e punës sociale në planifikimin, organizimin, zhvillimin dhe forcimin e komunitetit lokal.

- **Punë sociale me njerëz me nevoja të veçanta**

Studentët fitojnë njohuri të paanshme për përvojën teorike dhe praktike të zbatimit të kujdesit social. Studentët, duhet të jenë në gjendje të analizojnë dhe diskutojnë qasjet moderne për mbrojtjen e përdoruesve dhe për t'u mundësuar atyre që ta zbatojnë ata.

- **Varfëria dhe puna sociale**

Të fitojnë njohuri shkencore dhe në thellësi rreth fenomenit të varfërisë dhe përjashtimit social dhe për të fituar njohuri për analizimin e problemeve dhe masave që merren për çrënjosjen e saj.

- **Analiza dhe dizajnimi i pyetësorëve**

Qëllimi i lëndës është që të përqëndrohet në dy qasje të përgjithshme për analizën e të dhënave, domethënë, në atë sasiore dhe cilësore. Në aspektin e analizës sasiore, ajo fokusohet në përdorimin e analizave statistikore në aspektin e analizës cilësore në të cilën përcaktohet se si ato qasje që nuk përfshijnë qasjet sasiore - ose qasjet që nuk përdorin manipulimin numerik. Gjithashtu, ky kurs do të analizojë dhe prezantojë studimet e rasteve, metodat e hulumtimit, pjesët e hulumtimeve sociale, qasjet në hartimin e hulumtimit, zbatimin e dizajnit empirik dhe analizën multivariate.

- **Financat publike**

Studentëve u sigurohet njohuri lidhur me financat publike, si një nga rolet kryesore të politikave makroekonomike dhe instrumenteve themelore për funksionimin e një ekonomie kombëtare si një tërësi dhe si një nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit. Studentët njoftohen me njohuri për të mirat publike dhe shpenzimet, alokimin dhe rialokimin e të hyrave, aspektet krahasuese të financave publike në vendet e zhvilluara dhe atyre të tranzicionit, specifikat e sistemeve fiskale në Maqedoninë e Veriut, trendet dhe sfidat e të njëjtave, decentralizimi fiskal, etj. Njoftohen me njohuri profesionale lidhur me buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore, si instrumente kryesore të politikës fiskale, procedurave rreth përgatitjes, përpunimit, përmbledhjes, miratimit, krahasimit dhe kontrollit të buxhetit, si dhe teknikave të buxhetit si në nivel vendor ashtu edhe në atë qendror.

- **Strategjitë për kërkim të punës**

Lënda është projektuar t'i inkurajojë studentët në procesin e planifikimit të hershëm dhe zhvillimit të karrierës. Procesi përfshin vetanalizimin e thellë, hulumtimin e karrierës, planifikimin dhe mbikëqyrjen e strategjive paraprake për punësim, etj. Filozofia e lëndës është që ky proces është i vazhdueshëm, sistematik dhe ka për qëllim një jetë të plotësuar me punë, që është pjesë e planit të përgjithshëm për zhvillim personal.

- **Udhëheqja dhe të mësuarit**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një

strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Planifikimi i Zhvillimit Social**

Studentët fitojnë njohuri për arritjet shkencore në fushën e zhvillimit social, rëndësinë dhe nevojën për dinamikën e zhvillimit shoqëror, format e tij, metodat dhe fushat e shprehjes, përpilimin, planifikimin dhe kompetencat.